VENDIM
Nr. 380, datë 6.5.2015

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME, PËR NËNPREFEKTURËN PUKË, TË DISA OBJEKTEVE DHE TË NJË SIPËRFAQEJE TRUALLI FUNKSIONAL, ME SIPËRFAQE TË PËRGJITHSHME 1700 m^2, BRENDA TERRITORIT TË PRONËS ME NUMËR RENDOR 531, ME EMËRTIM "ISH-REPARTI USHTARAK NR. 2240, SHKOLLË INSTRUKSIONI, OFIÇINA E BRIGADËS SË KËMBËSORISË", ME VENDNDODHJE NË PUKË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së admini-strimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Punëve të Brendshme, për nënprefekturën Pukë, të disa objekteve dhe të një sipërfaqeje trualli funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 1700 (një mijë e shtatëqind) m^2, brenda territorit të pronës me numër rendor 531, me emërtim "Ish-Reparti Ushtarak nr. 2240, shkollë instruksioni, ofiçina e Brigadës së Këmbësorisë", me vendndodhje në Pukë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për vendosjen në mjedise pune dhe për sistemimin e Repartit të PMNZSH-së në qytetin e Pukës.

2. Objektet dhe sipërfaqja e truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 1700 (një mijë e shtatëqind) m^2, pjesë e pronës me numër rendor 531, me emërtim "Ish-Reparti Ushtarak nr. 2240, shkollë instruksioni, ofiçina e Brigadës së Këmbësorisë", me vendndodhje në Pukë, të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të hiqen nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, dhe të shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 1691, datë 10.10.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme, për prefektët në qarqe dhe administratën e prefektëve, nënprefektët dhe administratën e nënprefektëve dhe për Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile (Drejtorisë së PMNZSH-së)", të ndryshuar.

3. Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nënprefekturës Pukë, u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e objekteve dhe të sipërfaqes së truallit funksional të pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë ose t'ua japin në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Punëve të Brendshme, nënprefekti i Prefekturës Pukë, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Plan-vendosja e Pronës Nr.531

'Ish Reparti Ushtarak nr.2240 Shkollë Instruksioni , Ofiçina BrK', Pukë

(Sip. dhe Objektet që kërkohen për kalim në përgjisi administrimi nga MM te MPB.)

SISTEMI KOORDINATAVE SHTETERORE

MIRATOHET
Komandant i Komandës Mbështetëse
Gjeneral Brigade Ylber DOGJANI



Shpjegues.
Sip. përgjithshme = 22776.4 m2
Sip. që kërkohet për kalim në administrim të MPB. = 1700 m2 (përfshi objektet nr. 2,3,4)
Objektet me nr.2,3,4 me sip. ndërtimi = 310.6 m2 (objekti nr.3 rrën)
Sip. që do të mbetet rezervë = 21076.4 m2
—— Kufiri i rezervës

Shenim: Kjo plan-vendosje u përgatit në zbatim të shkresës me nr.5413/4 dt. 06.11.2014 të Sekretarit të Përgjithshëm të MM.
Sip. e kërkuar u përcaktua në terren nga përfaqësuesit e PMNZSH-së, Pukë dhe përfaqësuesit e Komandës Mbështetëse N/Kol. Ilmi DUHONI dhe Specialist Rifat HASA.
Mbi plan-vendosjen e marrë nga arkivi i I.GJ.I.U-së u mbivendos sipërfaqja e përcaktuar në terren.

Punuar Nëntor 2014

409 200 | 409 300 | 409 400 | 409 500

Shkalla 1:1000

PUNOI
ng.Albert MURATI

Përgj. Sek. R.Haxhiu

DREJTORI I IG.
N/Kol.Armir Ç.